

shkurteshqip

Shkurt e shqip / e-mail: shkurteshqip@gazetaexpress.com
tel: 038 76 76 76, fax: 038 76 76 78 adresa: Dardania 1/1, Prishtinë

Kosova dhe Ndryshimet Klimatike

Çuditërisht, për dallim nga e gjithë bota, kjo çështje në Kosovë po kalon dhe po trajtohet si një ngjarje pak e rëndësishme. Andaj, detyrimisht shtrohet pyetja: A mundet Kosova të qëndrojë indiferente ndaj ndryshimeve klimatike?

Afrim Berisha

Fillimi i punimeve të Konferencës së OKB'së për ndryshimet klimatike në Kopenhagë padyshim se është një ndër ngjarjet më të rëndësishme të vitit 2009.

Fakti se në konferencë do të marrin pjesë diplomatë të lartë nga 192 vendet më me ndikim të botës dhe se punimet e konferencës po ndiqen me vëmendje të posaçme nga mediumet më të fuqishme botërore, tregon për rëndësinë që ka arritja e një marrëveshjeje në këtë konferencë. Madje, ka edhe vlerësime të atilla të cilat këtë konferencë e konsiderojnë si mundësinë e vetme dhe më të mirën për ta mbrojtur planetin nga ndryshimet klimatike, duke e vënë këtë ngjarje në krye të prioritete të politikës globale.

Ka edhe vlerësime tjera të cilat ndryshimet klimatike, krahas terrorizmit, i konsiderojnë si sfidën më të madhe të njerëzimit për të ardhmen. Andaj, në përpjekjet për gjetjen e mënyrave të zvogëlimit të gazrave me efekt të serrës dhe faktorëve tjerë që kanë ndikim në ndryshimet klimatike, sot krahas ambientalistëve janë bashkuar jo vetëm shkencëtarët dhe institutet kërkimore shkencore, por edhe diplomatët dhe organizatat më të mëdha botërore.

Pra, është e qartë se ndryshimet



klimatike sot paraqesin një sfidë të përmasave globale, e cila kërkon përpjekjen dhe bashkëpunimin e të gjitha vendeve të botës pavarësisht nga kontributi që kanë në lirim dhe gazeve serrë në atmosferë, kërkon veprime urgjente në parandalimin e faktorëve të ndryshimeve klimatike, sepse ndikimi i tyre në ekzistencën e planetit tonë dhe ekzistencën e njerëzimit është gjithnjë e më evident.

Aq më tepër, për çdo ditë e më shumë të gjithë ne jemi dëshmitarë të ndryshimeve klimatike gjithnjë e më të theksuara që po ndodhin në planetin tonë. Shkrirja e akullnajave, rritja e thatësisë, tharja e pyjeve, uraganet, vërshimet dhe katastrofat tjera natyrore, janë vetëm disa prej ndryshimeve globale klimatike që tanimë janë të dukshme në çdo pjesë të botës. Pra, është fakt i pamohueshëm së përkundër dilemave dhe teorive të ndryshme ndryshimet klimatike janë duke ndodhur.

Çuditërisht, për dallim nga e gjithë bota, kjo çështje në Kosovë po kalon dhe po trajtohet si një ngjarje pak e rëndësishme. Andaj, detyrimisht shtrohet pyetja:

A mundet Kosova të qëndrojë indiferente ndaj ndryshimeve klimatike?

Të gjithë e kemi të qartë se ndër prioritetet kryesore të Kosovës është integrimi në Bashkimin Europian, andaj domosdo edhe qëndrimi i BE'së në Konferencën e Kopenhagës do të ketë ndikim edhe për Kosovën.

Sipas rrjedhëve dhe negociatave që kanë ndodhur para fillimit të konferencës, pritet që Bashkimi Europian, të marr nga Konferenca e Kopenhagës obligime në uljen e emetimeve të gazrave të serrës prej 20-30 për qind deri në vitin 2020. Madje, orientimet e Bashkimit Europian janë të atilla që reduktimi i gazrave të serrës të arrijë deri në 90 për qind deri në vitin 2050. Po ashtu, pritet që BE'ja të del me qëndrimin që edhe vendet e varfra të ngadalësojnë emetimin e gazrave të serrës.

Ky qëndrim i Bashkimit Europian patjetër që do të ketë implikime edhe për vendet candidate dhe ato candidate potenciale - ku bën pjesë edhe Kosova - për integrim në Bashkimin Europian.

Është e ditur se Kosova për

shkak të statusit të saj nuk mund të jetë nënshkruese e marrëveshjeve ndërkombëtare për ndryshimet klimatike, por në procesin e integritimeve europiane ajo do të detyrohet t'i përmbushë obligimet nga legjislacioni europian për limitimin e gazrave të serrës, e sidomos limitimin e gazrave të serrës nga impiantet me djegie të resurseve energjetike fosile.

Situata bëhet edhe më e vështirë kur e marrim parasysh faktin se prodhimi aktual i energjisë në Kosovë është i orientuar diku 98 për qind në prodhimin e energjisë nga linjtë. Po ashtu edhe planet strategjike për shtimin e kapaciteteve të reja energjetike janë të orientuara në prodhimin e energjisë nga linjtë.

Një fakt tjetër që duhet të jetë brengosës për Kosovën është edhe korniza aktuale ligjore, strategjike dhe institucionale e Kosovës në raport me ndryshimet klimatike.

Në kuadër të institucioneve mjedisore në Kosovë, ende nuk ka një sektor të veçantë për ndryshimet klimatike. Në kuadër të legjislacionit mjedisor, Kosova nuk ka ligj të veçantë për ndryshimet

klimatike, por kjo çështje pjesërisht rregullohet me ligjet tjera si Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Ligji i ajrit, Ligji për IPPC, etj. Kosova po ashtu ende nuk ka Strategji dhe Plan të Veprimit për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike. Pra, në planin e përgjithshëm nacional Kosova duhet të ndër marrë masa konkrete ligjore, institucionale dhe strategjike për t'i adaptuar nevojat në raport me ndryshimet klimatike.

Por, pavarësisht kësaj, duhet të theksohet se veprime në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike mund të ndërmerren edhe individualisht. Kështu, për shembull, nëse secili nga ne do të zbrit temperaturën në shtëpi për 1 gradë C, do ta zvogëlojë emetimin e CO2 për 300 kg në vit. Nëse secili nga ne do t'i përdorte ftohësit me shenje "A+", do ta zvogëlonte emetimin e CO2 për 210 kg në vit dhe nëse secili nga ne do ta mbillte një dru, do të kontribuonte në uljen e sasisë së CO2 për një ton, për periudhën sa mund të thithë CO2 një dru gjatë jetës së tij.

Në uljen e sasisë së gazrave të serrës me ndikim në ngrohjen globale ne si shoqëri mund të ndërmarrim shumë veprime konkrete. Duke kursyer energjinë elektrike, duke favorizuar përdorimin e transportit publik, duke larguar nga qarkullimi veturat e vjetruara, duke përmirësuar menaxhimin e mbeturinave, duke mbrojtur pyjet, duke ripyllëzuar sipërfaqet e zhveshura, duke zgjeruar sipërfaqet e mbrojtura edhe ne mund të bëhemi pjesë e përpjekjeve globale për t'i parandaluar ndryshimet klimatike.

Përfundimisht, Konferenca e Kopenhagës për Ndryshimet Klimatike është një ngjarje shumë e rëndësishme për të ardhmen dhe ruajtjen e planetit tokë, pjesë e të cilit jemi edhe ne.

Andaj, me këtë rast dua të rikujtoj edhe njëherë se ne si gjeneratë e kemi për obligim t'i lëmë trashëgim gjeneratave pasardhëse një planet po aq të shëndoshë, sa ai që e kemi trashëguar nga gjeneratat paraardhëse.

■ Autori është

MSc. në Ekologji dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Zëdhënës i Lëvizjes BELLS (Balkan Environmental Life Leadership Standard) dhe Rrjetit REA (Regional Environmental Ambassadors) për Kosovë.